



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 36, datë 31.03.2016

MBI

**MIRATIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR
MBIKËQYRJEN E TREGUT TË SIGURIMEVE, NDËRMJET AUTORITETIT TË
MBIKËQYRJES FINANCIARE (SHQIPËRI) DHE AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË
SIGURIMEVE (SLLOVENI)**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, dhe nenit 18/1, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni).
2. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në lidhje me Bashkëpunimin Reciprok dhe Shkëmbimin e Informacionit

për Mbikëqyrjen e Tregut të Sigurimeve

ndërmjet

Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri)

dhe

Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni) (në vijim – Palët), duke marrë në konsideratë rritjen e treguesve të zhvillimit ndërkombëtar në tregun e sigurimeve dhe nevojën për bashkëpunim reciprok, shprehin vullnetin e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e besimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bien dakord që bashkëpunimi i tyre për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve të bazohet në parimet dhe procedurat e përshkruara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Palët dëshirojnë të krijojnë një bazë formale për bashkëpunim dhe koordinim reciprok, si dhe të sigurojnë shkëmbim informacioni dhe përvojat përkatëse me njëra-tjetrën lidhur me përgjegjësitë mbikëqyrëse, rregullatore dhe kontrolluese.

Kuadri i përgjithshëm i këtij memorandumi përfshin Parimet Bazë të Sigurimeve për Mbikëqyrjen Efektive të Sigurimeve të vendosura nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) (në vijim: Parimet Bazë).

I. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim – MM) është mbrojtja e interesave të të siguruarve të shoqërive të sigurimit, si dhe promovimi i integritetit, stabilitetit dhe efikasitetit të industrisë së sigurimeve duke ofruar një kuadër për bashkëpunim, duke përfshirë mënyra komunikimi, duke zhvilluar mirëkuptimin reciprok, shkëmbimin e informacionit, si dhe duke dhënë asistencë deri në kufijtë që lejohet nga ligji vendas i Palëve.
2. Ky MM shërben si bazë për bashkëpunimin midis Palëve dhe nuk cënon asnjë detyrim ligjor sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të nënshkruara me Palë të treta. Ky MM nuk është i detyrueshëm ligjërisht.
3. Zbatimi i këtij MM do të bëhet brenda disponueshmërisë së burimeve respektive të Palëve, në përputhje me ligjin vendas dhe interesat publike të shteteve të Palëve përkatëse.
4. Sipas ligjit vendas të shteteve të Palëve, secila Palë do t'i ofrojë Palës tjetër, brenda një kohe të përshtatshme dhe deri në masën që është e pranueshme, çfarëdolloj informacioni që ngre dyshime për një shkelje ose shkelje të parashikuar të kritereve rregullatore ose të ligjeve në tregun e sigurimeve të administruar nga Pala tjetër.

II. Përkufizime

Për qëllime të këtij MM:

1. “Palë” nënkupton:
 - a. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Shqipëri);
 - b. Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (Slloveni).
2. “Pala Kërkuese” nënkupton Palën që bën një kërkesë sipas këtij MM.
3. “Pala e Kërkuar” nënkupton Palën së cilës i drejtohet një kërkesë sipas këtij MM.
4. “Shoqëri Sigurimi” nënkupton siguruesin, risiguruesin dhe grupi i (ri-) sigurimit ose një pjesë e tij.
5. “Person” nënkupton një person fizik ose subjekt ligjor i themeluar sipas ligjit vendas të Palëve.
6. “Ligji vendas” nënkupton çdo ligj ose rregullore në fuqi, i cili zbatohet në mbikëqyrjen e sigurimeve në juridiksionet e shteteve të Palëve.
7. “Informacion Konfidencial” nënkupton çdo informacion që konsiderohet konfidencial nga ligji vendas i shteteve të Palëve.

III. Shtrirja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Palët bien dakord që të promovojnë ndihmën e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacionit midis tyre për t'i ndihmuar ato në kryerjen e funksioneve të tyre respektive, sipas ligjit vendas të shteteve të Palëve, për sa i përket drejtimeve të mëposhtme:
 - a. Dispozitat ligjore që trajtojnë propozimet për themelimin, blerjen dhe marrjen në kontroll të shoqërive të sigurimit;
 - b. Dispozita për informacione mbi individët që zotërojnë pozicione me përgjegjësi në shoqëritë e sigurimeve (duke përfshirë pronarët, aksionarët, drejtuesit, menaxherët, punonjësit ose kontraktorët);
 - c. Monitorimi, auditimi, inspektimi dhe ekzaminimi i vazhdueshëm i shoqërive të sigurimit për pajtueshmëri me raportimin e kujdesshëm, financiar dhe kritere të tjera të mbikëqyrjes;
 - d. Adresimi i pyetjeve specifike mbi aktivitete të shoqërive të veçanta të sigurimit;
 - e. Verifikimi i respektimit të kritereve të ligjit vendas në lidhje me shpërndarjen e informacionit dhe marketingun e produkteve të sigurimit;
 - f. Praktika mashtrimi në lidhje me ofertën, blerjen ose shitjen e produkteve të sigurimit;
 - g. Bashkëpunimi dhe asistenca teknike;
 - h. Çështje të tjera për të cilat është rënë dakord dhe brenda kompetencës së Palëve.

IV. Kërkesat dhe Zbatimi

1. Kërkesat do të bëhen me shkrim në gjuhën angleze dhe do t'i drejtohen personave përgjegjës të kontaktit. Në raste urgjente, kërkesat mund të bëhen në formë të përmbledhur dhe do të pasohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga një kërkesë e plotë.

2. Çdo kërkesë duhet të specifikojë:

- a. Kërkesën për koordinim ose informacion;
- b. Qëllimin për të cilin kërkohet informacioni (duke përfshirë detajet e ligjeve dhe kritereve rregullatore që i përkasin çështjes që është subjekt i kërkesës);
- c. Detajet e kërkesës, duke përfshirë informacione për personin ose subjektin përkatës, siç është përshkrimi i fakteve në kërkesë dhe pyetjet specifike për t'u drejtuar;
- d. Lidhja ndërmjet ligjeve specifike apo kritereve rregullatore dhe funksioneve rregullatore të Palës kërkuese;
- e. Personat që Pala kërkuese beson se zotërojnë informacionet e kërkuara ose vendi ku këto informacione mund të merren, nëse Pala kërkuese është në dijeni të tyre;
- f. Personin, nëse do të ketë, për të cilin dhënia e informacionit mund të jetë e nevojshme dhe arsyen për atë dhënie informacioni;
- g. Periudhën e dëshiruar kohore për kthim përgjigje.

3. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të trajtojë kërkesën brenda një kohe të arsyeshme.

4. Çdo kërkesë do të vlerësohet nga Pala së cilës i drejtohet për të përcaktuar nëse informacioni i kërkuar mund të jepet sipas kushteve të këtij MM. Në çdo rast ku kërkesa nuk mund të pranohet plotësisht, Pala së cilës i drejtohet kërkesa do të marrë në konsideratë nëse mund të ketë informacione të rëndësishme ose informacione të pjesshme, i cilat mund të jepen bashkë me shpjegimet e nevojshme.

5. Në lidhje me vendimin për të pranuar ose refuzuar një kërkesë, Pala së cilës i drejtohet kërkesa do të ndërmarrë këto procedura të brendshme:

- a. Do të kontrollojë nëse kërkesa lidhet me shkeljen e ligjeve ose rregulloreve dhe nuk ka lidhje me shtetin e Palës së cilës i drejtohet kërkesa;
- b. Do të kontrollojë nëse do të ketë në dispozicion asistencë të njëjtë nga Pala kërkuese;
- c. Do të kontrollojë nëse do të jetë kundër interesave publike të Palës së cilës i drejtohet kërkesa.

6. Nëse kërkohet, çdo dokument ose material tjetër i dhënë në përgjigje të një kërkesë sipas këtij MM dhe çdo kopje e tij duhet të kthehet tek Pala së cilës i drejtohet kërkesa.

V. Informacioni i dhënë

Kur njëra Palë ka një informacion, i cili do të ndihmojë Palën tjetër në kryerjen e funksioneve të saj rregullatore, Pala e parë mund ta japë në mënyrë vullnetare një informacion të tillë, ose të marrë masa për dhënien e atij informacioni, deri në masën që lejohet nga ligji vendas i vetë Shtetit, edhe pse asnjë kërkesë nuk është bërë nga Pala tjetër dhe sigurohet ruajtja e informacionit konfidencial.

VI. Përdorimi i Lejuar dhe Konfidencialiteti

1. Pajtueshmëria me detyrimet e sekretit profesional nga ana e të gjithë punonjësve dhe zyrtarëve që marrin informacione nga vendi tjetër përkatës gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre është një kusht i nevojshëm për bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet Palëve.

2. Secila Palë do të mbajë konfidenciale:

- a. Çdo kërkesë për informacion të bërë sipas këtij MM dhe të gjitha çështjet që lindin gjatë kohëzgjatjes së tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e informacionit është e nevojshme për të realizuar kërkesën;
- b. Çdo informacion të miratuar në këtë MM, me përjashtim të rasteve kur ai jepet në vijim të qëllimit për të cilin është kërkuar.

3. Pala kërkuuese mund ta përdorë informacionin vetëm për qëllimin e cituar në kërkesë. Nëse Pala kërkuuese synon që të përdorë informacionin e dhënë për ndonjë qëllim tjetër, ajo duhet të marrë miratimin paraprak të Palës së cilës i drejton kërkesën, e cila mund të kushtëzojë informacionin në kushte të caktuara.

4. Secila Palë, sipas ligjit vendas do të mbajë konfidenciale deri në masën e lejuar nga ligji çdo kërkesë që bëhet në kuadrin e këtij MM, si dhe çdo çështje që lind gjatë veprimtarisë së saj.

5. Deri në masën e lejuar nga ligji, secila Palë do të mbajë konfidencial çdo informacion të miratuar në MM deri në të njëjtin nivel që jepet nga ligji në shtetin e Palës tjetër.

6. Informacioni ose asistenca e dhënë sipas MM do t'i jepet Palëve të treta vetëm me miratimin e Palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe për qëllimin e miratuar nga Pala së cilës i është drejtuar kërkesa.

7. Përpara dhënies së informacionit të marrë në vijim të këtij MM tek Palët e treta, Pala kërkuuese do të marrë një garanci me shkrim nga këto Palë të treta për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit.

VII. Bashkëpunimi Teknik

1. Palët synojnë të punojnë së bashku për të identifikuar dhe adresuar, në varësi të disponueshmërisë së personelit dhe burimeve, trajnimin dhe asistencën teknike të nevojshme për të lehtësuar zhvillimin e kuadrit rregullator për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe në Slloveni.

2. Palët do të zhvillojnë dhe lehtësojnë shkëmbimin e njohurive, përvojës dhe ekspertizës ndërmjet përfaqësuesve të Palëve dhe ku është e përshtatshme, ndërmjet institucioneve të tjera të përfshira në çështjet e mbikëqyrjes së sigurimeve.

Bashkëpunimi i përshkruar më sipër mund të marrë formën e secilës prej aktiviteteve të mëposhtme:

- Vizita konsulente të ekspertëve nga Palët përkatëse;
- Pjesëmarrje në seminare, *workshop*-e dhe konferenca në vendin e secilës Palë;
- Shkëmbim dokumentacioni;
- Çdo formë tjetër bashkëpunimi që mund të vendoset bashkarisht.

VIII. Konsultimi

1. Palët do të konsultohen, në rast mosmarrëveshjeje, për kuptimin e çdo termi të përdorur në këtë MM.

2. Palët mund të konsultohen, në çdo kohë, në lidhje me një kërkesë të veçantë.

3. Palët mund të konsultohen dhe të rishikojnë termat (kushtet) e MM në rastin e një ndryshimi thelbësor në ligje, rregullore ose praktika që ndikojnë në funksionimin e këtij MM. Të gjitha këto ndryshime do të bëhen pas marrëveshjes së të dyja Palëve në formë të shkruar.

4. Për të përmirësuar bashkëpunimin sipas këtij MM, Palët do të zhvillojnë konsultime dhe diskutime mbi zbatimin e MM në mënyrë periodike ose sa herë që të jetë e nevojshme.

IX. Personat Përgjegjës të Kontaktit

Të gjitha komunikimet ndërmjet Palëve duhet të bëhen ndërmjet personave përgjegjës të kontaktit të cituar në Aneksin A. Personat përgjegjës të kontaktit caktohen nga Palët. Informacioni për personat përgjegjës të kontaktit dhe të gjitha ndryshimet e tyre paraqiten nëpërmjet njoftimit me shkrim nga secila Palë.

X. Zbatueshmëria

1. Ky MM shërben si bazë për fillimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve. Ai nuk synon të krijojë as detyrime ligjore, as të zëvendësojë ndonjë ligj apo kriter rregullator në fuqi në Slloveni apo në Shqipëri. Ky MM nuk krijon asnjë të drejtë të zbatueshme nga palët e treta.
2. Zbatimi i dispozitave të këtij MM do të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendase të vendeve respektive të Palëve dhe nuk do të jetë në kundërshtim me interesin publik të vendit të secilës prej Palëve.
3. Secila Palë do të mbulojë kostot që lindin nga çdo formë bashkëpunimi dhe asistence bazuar në këtë MM. Megjithatë, secila Palë mund të mbulojë kostot financiare të Palës, vullnetarisht dhe në pajtim me legjislacionin lokal, nëse këto kosto janë shkaktuar nga bashkëpunimi mbi bazën e këtij MM.

XI. Hyrja në Fuqi dhe Amendamentet e MM

1. Ky MM lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe është i vlefshëm për sa kohë që Palët kanë interes reciprok. Ky MM mund të përmirësohet në çdo kohë me miratimin e përbashkët me shkrim të të dyja Palëve.
2. Ky MM hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij nga Palët kontraktore.
3. Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të zgjidhur me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin e këtij MM.

XII. Përfundimi

1. Ky MM do të mbetet në fuqi derisa njëra prej Palëve të njoftojë me shkrim Palën tjetër se ajo dëshiron të rishikojë, përmirësojë ose të tërhiqet nga ky MM. Secila Palë mund t'i japë fund këtij MM duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër. Ky MM do të përfundojë tre muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Pala tjetër.
2. Përfundimi i këtij MM nuk do të ndikojë në kërkesat e Palëve për informacion, të cilat janë bërë dhe nuk janë realizuar përpara datës së hyrjes në fuqi të përfundimit. Në të njëjtën kohë, kushtet për ruajtjen e informacionit konfidencial në lidhje me këto kërkesa do të mbeten në fuqi.
3. Në rastin e përfundimit të këtij MM, informacioni i marrë në kuadër të këtij MM do të vazhdojë të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

Ky memorandum është përgatitur në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze, ku secili prej teksteve është njëlloj autentik.

Tiranë më __/__/2016

dhe në Ljublanë më __/__/2016

Në emër të
**Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare
(Shqipëri)**

Zj. Enkeleda SHEHI
Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive

Në emër të
**Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve
(Slloveni)**

Z. Sergej SIMONITI
Drejtore

Aneks A

Kontaktet Kryesore

Kontaktet kryesore të përcaktuar për komunikim dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet Palëve, siç parashtrohen në këtë Marrëveshje janë si vijon:

Për AMF

Rr. Dora d'Istria, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

(Titulli)

Tel: +355 4 2 251 355
Faks: +355 4 2 250 686
E-mail:
www.amf.gov.al

Për AMS

Trg republike 3, 1000
Ljubljana, Slloveni

(Titulli)

Tel: + 386 (1) 2528 600
Fax: + 386 (1) 2528 630
E-mail:
www.a-zn.si

MEMORANDUM OF UNDERSTANDING

**Regarding Mutual Co-operation and Exchange of Information
in the Field of Insurance Supervision**

between

Financial Supervisory Authority (Albania)

and

Insurance Supervision Agency (Slovenia)

The Financial Supervisory Authority (Albania) and the Insurance Supervision Agency (Slovenia) (hereinafter—the Parties), recognising the increasing international development indicators in the insurance market and the need for mutual co-operation, express their willingness to co-operate on the basis of mutual trust and understanding and agree to base their co-operation in the field of insurance supervision on the principles and procedures outlined in this Memorandum of Understanding.

The Parties desire to establish a formal basis for mutual cooperation and coordination and to provide the exchange of information and experiences relevant to each others in the field of supervisory, regulatory and examination responsibilities.

The general framework of this memorandum are the Insurance Core Principles for Effective Insurance Supervision issued by the International Association of the Insurance Supervisors (IAIS) (hereinafter: Core Principles).

I. Purpose of Memorandum of Understanding

1. The purpose of this Memorandum of Understanding (hereinafter – MoU) is to protect the interests of policyholders of insurance companies, and promote the integrity, stability and efficiency of the insurance industry by providing a framework for co-operation, including channels of communication, increasing mutual understanding, the exchange of information and assistance to the extent permitted by domestic law of the Parties.
2. This MoU serves as a basis of co-operation for the Parties and does not affect any legal obligations under other international agreements signed with third Parties. This MoU is not legally binding.
3. The implementation of this MoU shall be made within the availability of respective resources of the Parties, consistent with the domestic law and public interests of the states of the Parties concerned.
4. According to the domestic law of the states of the Parties, each Party will provide the other Party, in good time and to the extent reasonable, with any information, giving rise to a suspicion of a breach, or anticipated breach, of the regulatory requirements or laws in the insurance market administered by the other Party.

II. Definitions

For the purposes of this MoU:

1. “Party” means:
 - a. The Financial Supervisory Authority (Albania);
 - b. The Insurance Supervision Agency (Slovenia).
2. “Requesting Party” means the Party making a request under this MoU.
3. “Requested Party” means the Party to whom a request is made under this MoU.
4. “Insurance Company” means insurer, reinsurer and (re-)insurance group or a part thereof.
5. “Person” means a natural person or legal entity established according to the domestic law of the Parties.
6. “Domestic Law” means any laws or regulation in force, applicable in the jurisdictions of the states of the Parties relevant to insurance supervision.
7. “Confidential Information” means any information regarded as confidential by the domestic law of the states of the Parties.

III. Scope of Memorandum of Understanding

1. The Parties agree to promote mutual assistance and the exchange of information between each other to assist them to perform their respective functions, according to the domestic law of the states of the Parties, in relation to the following directions:
 - a. The legislative provisions dealing with proposals for the establishment, acquisition and take-over of insurance companies;
 - b. Provision of information on individuals holding positions of responsibility in insurance undertaking (to include owners, shareholders, directors, managers, employees or contractors);
 - c. The continuing monitoring, auditing, inspection and examination of insurance companies for compliance with prudential, financial reporting and other supervisory requirements;
 - d. The conduct of specific inquiries into the activities of individual insurance companies;
 - e. Check of respecting the requirement of domestic law of the own state regarding disclosure of information and of marketing of insurance products;
 - f. Fraudulent practices in relation to the offer, purchase or sale of insurance products;
 - g. Technical co-operation and assistance;
 - h. Other issues agreed upon and within the competency of the Parties.

IV. Requests and Execution

1. Requests will be made in writing in the English language to the responsible contact persons. In urgent cases, requests may be made in summary form to be followed as soon as possible by a full request.

2. Any requests should specify:

- a. Request for co-ordination or information;
- b. The purpose for which the information is sought (including details of the laws and regulatory requirements pertaining to the matter which is the subject of the request);
- c. Details of the request comprising information on the person or entity concerned, such as a description of the facts underlying the request and specific questions to be asked;
- d. The link between the specific laws or regulatory requirements and the regulatory functions of the requesting Party;
- e. The persons believed by the requesting Party to possess the information sought, or the place where such information may be obtained, if the requesting Party is knowledgeable thereof;
- f. To whom, if anyone, onward disclosure of information is likely to be necessary and the reason for such disclosure;
- g. The desired time period for the reply.

3. The requested Party will deal with the request in a reasonable time.

4. Each request will be assessed by the requested Party to determine whether the information requested can be provided under the terms of this MoU. In any case where the request cannot be accepted completely, the requested Party will consider whether there may be any relevant or partial information, which can be given with all necessary explanations.

5. In deciding whether to accept or decline a request, the requested Party will undertake such internal procedures:

- a. Examine whether the request relates to the breach of laws or regulations which has no close parallel in the state of the requested Party;
- b. Examine whether broadly equivalent assistance would be available from the requesting Party;
- c. Examine whether it would be contrary to the public interests of the requested Party.

6. Any document or other materials provided in response to a request under this MoU and any copies thereof must be returned to the requested Party on request.

V. Unsolicited Information

Where one Party has information, which will assist the other Party in the performance of its regulatory functions, the former may provide such information, or arrange such information to be provided, to the extent permitted by law of the own State, on a voluntary basis even though no request has been made by the other Party and provided confidential information safekeeping.

VI. Permissible Use and Confidentiality

1. Compliance with the obligations of professional secrecy by all employees and officials who receive information from the respective other country in the course of their activities is a necessary condition for successful co-operation between the Parties.
2. Each Party will keep confidential:
 - a. any request for information made under this MoU and any matters arising in the course of its operation, unless such disclosure is necessary to carry out the request;
 - b. any information passed under this MoU unless it is disclosed in furtherance of the purpose for which it was requested.
3. The requesting Party may use the information solely for the purpose stated in the request. If the requesting Party intends to use the information furnished for any other purpose, it must obtain prior consent of the requested Party, which may subject the information to certain conditions.
4. Each Party, according to the domestic law will keep confidential to the extent permitted by law any request made under this MoU as well as any matter arising in the course of its operation.
5. To the extent permitted by law, each Party will keep confidential any information passed under the MoU to the same degree as provided by law in the state of the other Party.
6. Information or assistance provided under the MoU will only be disclosed by the recipient to any third parties by consent of the requested Party and for the purpose approved by the requested Party.
7. Prior to disclosing information received pursuant to this MoU to third parties, the requesting Party will obtain a written assurance from such third parties to keep the information confidential.

VII. Technical Co-operation

1. The Parties intend to work together to identify and address, subject to the availability of personnel and resources, the training and technical assistance required to facilitate the development of the regulatory framework for the insurance market both in Albania and Slovenia.
2. The Parties shall expand and facilitate the exchange of knowledge, experience and expertise between representatives of the Parties and where appropriate between other relevant institutions involved in insurance supervisory matters.

3. The cooperation described above can take the form of any of the following activities:

- Consulting visits of experts of the respective Parties;
- Participation in seminars, workshops and conferences in the country of either Party;
- Exchange of documentation;
- Any other form of cooperation that may be mutually decided upon.

VIII. Consultation

1. The Parties will consult, in the event of a dispute, the meaning of any term used in this MoU.

2. The Parties may consult, at any time, about a particular request.

3. The Parties may consult and revise the terms of the MoU in the event of a substantial change in the laws, regulations or practices affecting the operation of the MoU. Any such changes will be done after both Parties' agreement in written form.

4. To improve the co-operation under this MoU, the Parties will conduct consultations and discussions on the implementation of the MoU periodically or when necessary.

IX. Responsible Contact Persons

All communications between the Parties should be made between the responsible contact persons as stated in the Annex A. Responsible contact persons are designated by the Parties. Information on designated contact persons and any of its changes are submitted by written notice from either Party.

X. Applicability

1. This MoU serves as basis for cooperation between the Parties. Neither does it intend to create any legally binding obligations, nor supersede any laws or regulatory requirements in force in Slovenia or in Albania. This MoU does not create any rights enforceable by third parties.

2. The enforcement of the provisions of this MoU shall be consistent with the national laws and regulations of the respective countries of the Parties and shall not be contrary to the public interest of the country of any of the Parties.

3. Each Party shall bear the costs arising from any form of cooperation and assistance based on this MoU. However, any Party can cover financial costs of other Party, based on its voluntary decision and with respect to their national legislation, if these costs were created by cooperation on the basis of this MoU.

XI. Entry into Force and Amendments of the MoU

1. This MoU is concluded for an indefinite period and is valid as long as both Parties find mutual interest. This MoU may be amended at any time with the mutual written consent of both Parties.
2. This MoU comes into force and effect from the date of its signature by contractual Parties.
3. The parties will use their best efforts to settle amicably any dispute that may arise in connection with the implementation of this MoU.

XII. Termination

1. This MoU shall remain in existence until one of the Parties notifies the other Party in writing its wish to revise, amend or withdraw from this MoU. Each Party may terminate this MoU by giving written notice to the other Party. The MoU will be terminated in three months after the date of receiving such notice by the other Party.
2. Termination of this MoU will not affect the Parties requests for information that have been made and not performed before the effective date of termination. At the same time terms of confidential information safekeeping regarding such requests will be in effect.
3. In the event of termination of this MoU, information obtained under this MoU will continue to be treated confidentially.

This MoU has been prepared in four (4) original copies, two (2) in Albanian and 2 (two) in English, each text being equally authentic.

Tirana on __/__/2016

and in Ljubljana on __/__/2016

**On behalf of the
Financial Supervisory Authority
(Albania)**

Ms. Enkeleda SHEHI
General Executive Director

**On behalf of the
Insurance Supervision Agency
(Slovenia)**

Mr. Sergej SIMONITI
Director

Annex A

Responsible Contact Persons

The responsible contact persons for the communication and exchange of information between the Parties as set out in this MoU are as follows:

For the AFSA

Dora d'Istria Str, Nr. 10
Tirana, ALBANIA

(title)

Tel: +355 4 2 251 355
Faks: +355 4 2 250 686
E-mail:
www.amf.gov.al

For the ISA

Trg republike 3, 1000
Ljubljana, SLOVENIA

(title)

Tel: + 386 (1) 2528 600
Fax: + 386 (1) 2528 630
E-mail:
www.a-zn.si